



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 1/8 Prot

Vlorë, më 26 . 01 . 2022.

VENDIM

Nr.2, datë 24.01.2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
NËNTOKËSOR PËR UJË TË PIJSHËM, NË RASTIN KUR PËRDORIMI ËSHTË ≤ 1  
L/SEK, NGA BURIMET E UJIT TË FTOHTË, TEPELENË ME VENDNDODHJE,  
BASHKIA TEPELENË, QARKU GJIROKASTËR



Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së z. Bruno Hysi për përdorim të burimit ujor nëntokësor për ujë të pijshëm, në rastin kur përdorimi është  $\leq 1$  l/sek, nga Burimet e Ujit të Ftohtë, Tepelenë me vendndodhje, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Uji i Ftohtë, Tepelenë

Vendodhja e burimit ujor (KRGJSH)

X=505473; Y=4457268; Z=200 m.m.n.d

Qmes=200 l/s

Sasia e ujit që jepet për përdorim;

Q=1 l/s

Vendodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

X=505593; Y=4457330; Z=163 m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

X=505604; Y=4457371; Z=151 m.m.n.d

Prurja që do të shkarkohet

Q=1 l/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI**  
**FLAMUR MAMAJ**  
  
